

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

Marrëveshja me Emiratet e Bashkuara e sjellë sot, pa as më të voglin diskutim, gjen mbështetjen e çdo parlamenti në këtë parlament, por kjo marrëveshje duhet të sigurojë një mbështetje më të gjerë dhe më të besueshme nëse do të vinte si një vullnet i qeverisë për të luftuar krimin e organizuar. Kjo marrëveshje, për fat keq, nuk vjen si vullnet i qeverisë, por vjen si kërkesë e vazhdueshme e qeverisë së Emirateve të Bashkuara. Tashmë të gjithë e dimë se Dubai i famshëm është bërë një fole, ku të gjithë të kërkuarit janë atje, të gjithë kokat e kimit të organizuar dirigjojnë çdo gjë nga atje.

Fakti që Emiratet e Bashkuara kërkojnë, si hap të parë, marrëveshjen për shkëmbim informacioni, të jeni të sigurt se shumë shpejt ata do t'ju kërkojnë marrëveshje për luftën kundër kimit të organizuar dhe për ekstradim, sepse ju nuk e keni pasur dhe nuk e keni këtë vullnet. Ju e dini dhe nuk keni nevojë për shkëmbim informacioni që të mësoni se Dubai është bërë një nga qendrat kryesore të kimit të organizuar shqiptar. Këtë e di çdokush, por ju nuk keni ndërmarrë asnjë hap dhe sot jemi përballë kësaj situate, e cilësoj, për shkak se është vullneti i qeverisë së Emirateve të Bashkuara për këtë marrëveshje. Pra, Dubai është një oaz i kimit të organizuar. Po kush e shndërroi Dubain në këtë oaz? Sipas informacioneve janë rreth 20 krerë të bandave kriminale që janë në kërkim dhe që strehohen atje.

Nga Dubai blihen pasuri të patundshme me paratë e drogës që tregtohet atje. Nga Dubai vijnë porosi për vrasje e likuidime, vijnë lumë parash droge dhe krimi, që investohen në kulla në Tiranë dhe në Shqipëri. Dubai, si qytet, është shumë i dashur për qeverinë dhe për Kryeministrin tonë, sepse kur flitet për Dubain në Shqipëri i kujtohet porti i Durrësit. Sivëllai i Kryeministrit tonë, Vuçiq, i tregoi Edi Ramës përvojën që kishte me një lagje që u ndërtua në Beograd dhe, sigurisht, ai ia rekomandoi dhe skemën e zhvatjes së truallit në portin e Durrësit dhe të përfitimit të miliarda eurove në këtë aferë.

Pra emri i Dubait, pavarësisht se është një qytet shumë i bukur me shumë vlera, është i njohur nga shqiptarët për krimin dhe për korrupsionin e qeverisë së Edi Ramës. Kjo qeveri, ky ministër, që është mbrapa, dhe të gjithë paraardhësit e tij që nga viti 2013 e deri më sot, nuk kanë qenë dhe nuk janë në gjendje të luftojnë krimin. Marrëveshje dhe ligje, pa as më të voglin diskutim, janë bërë dhe bëhen në këtë parlament, qeveria e “Rilindjes” ka bërë në këto vite, sa nuk ka bërë asnjë qeveri tjetër. Por çfarë janë ato? Janë thjesht terminologji që ngelen në letër, sepse kur vjen puna te zbatimi nuk ekziston asgjë.

Kjo qeveri, që nga ish-ministri Tahiri deri te ministri aktual, nuk ka mundur të luftojë krimin, aq më tepër të pretendohet se mund të zbulojë krimet. Në Shqipëri njerëzit zhduken, vriten e rrëmbehen. Në Shqipëri shteti, Ministria e Brendshme janë thjesht institucion statistikash. Qytetarët e dinë, ndaj askush nuk pret rend dhe siguri publike as nga ministri, as nga policia dhe as nga qeveria, pra nga asnjë. Drejtorët që emërojnë këta paguhen nga bandidët, nga krimi i organizuar, si në asnjë vend tjetër në Europë. Kjo ndodh vetëm në vendet e botës së tretë. Pra, rroga e shtetit për ta nuk është asgjë, paratë e krimit dhe të drogës janë rrogë për vartësit e zotit ministër. Atëherë, a mund të presë ndokush rend dhe siguri nga kjo qeveri, kur jemi në një situatë të tillë?!

E thashë që mund të firmosim 1, 10, 100, pa fund marrëveshje, por krimi nuk luftohet. Përse? Sepse avokatët e krimit janë këtu: zotëria që mungon e të gjithë të tjerët. Avokatura e krimit këtu bëhet, është mbrojtja më e mirë që është bërë ndonjëherë në histori. Edi Rama ka ndërruar disa ministra të Brendshëm, ka ndërruar edhe drejtorë të përgjithshëm, por a keni parë në këta 10 vjet, qoftë edhe për një moment, që gjendja e rendit dhe e sigurisë në këtë vend të jetë përmirësuar? Jo, vetëm është përkeqësuar. E përse? Ka një arsye: që nga Kryeministri dhe e gjithë kjo çeta këtu janë të kapur për fyti nga krimi dhe nga korrupsioni. Kur je i kapur, sigurisht që rendi, siguria, shteti, ligji dhe drejtësia përfundojnë në këtë katandi, ku ka përfunduar me këtë qeveri.

A mund të ndodhë në ndonjë vend tjetër, që drejtori i policisë të thotë se 14 kriminelë që janë në drejtim të paditur, nuk janë kapur se aksionet janë dekonspiruar? Janë tradhtuar nga vetë trupa policore, nga elita, siç e quajnë këta. Askush nuk ndihet dhe nuk merret asnjë masë. Në

një vend europian, të jeni të sigurt që ministri minimalisht do të jepte dorëheqjen, por edhe Kryeministri përballë një situatë të tillë do të kishte dhënë dorëheqjen me 10-tra herë, ndërsa këtu asnjë. Këtu, ai që tregoi të vërtetën, u linçua dhe u shpall armik, pavarësisht se deri dje këta e quanin “njeriu mbret i luftës kundër krimit”, pra e shitën si hero kur e sollën, ndërsa tani e shpallin armik. E përse? Sepse guxoi të thoshte të vërtetën.

Përgjegjësi? Jo, jo, përgjegjësi nuk mban askush dhe as nuk ia ndjen askujt për përgjegjësi. Ne kemi 10 vjet që presim dhe në këta 10 vjet çdokush që mund të ishte në krye të këtij vendi do të bënte një ose dy hapa minimalisht, për ta modernizuar organizatën e Policisë së Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese. A ka ndodhur kjo? Asgjë nuk ka ndodhur. Që nga dita që janë ulur në karrige të pushtetit deri më tani kjo organizatë kriminale, që është këtu mbrapa, ka bërë vetëm një gjë, punë të palodhur dhe të pareshtur për ta shpartalluar Policinë e Shtetit, ndaj sot është në një pikë që po shkon pa kthim.

Është e vështirë që Policia e Shtetit të kthehet më në binarët e ligjit dhe të kthehet në një organizatë që lufton krimin dhe që besohet se mund të luftojë krimin. Këto afatet me 100 ditë i kemi dëgjuar ne! Sa herë që Kryeministri ndihet në siklet, kur krimi e vë përpara, del dhe jep afate me 100 ditë. Këto afatet me 100 ditë janë bërë si puna e barsoletave. Kjo është pasqyra. Ju bëni sa të doni marrëveshje, por vetëm një marrëveshje ka, ajo me qytetarët shqiptarë, për të larguar çetën e hajdutëve dhe të banditëve nga këtu dhe për të sjellë një qeveri dinjitoze, me vullnet politik, me zero tolerancë kundër krimit dhe korrupsionit. Këta e zhbënë këtë vend, këta kurrë nuk mund ta bëjnë, ndaj duhet të ikin. Ka vetëm një rrugë, ajo është ikja e tyre. Faleminderit!